



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 1538 Prot.

Patos më, 12/06/2024



MIRATOHET  
KRYETARI  
Fation Duro

PROJEKT-VENDIM

Nr. 49, datë 12.06.2024

**PËR BLERJE RËRË BITUMINOZE PËR SHTRIMIN RRUGËS NGA “QENDRA E SIQECËS DERI NË QENDRËN E DRENIES” ME VLERË 3,003,588 LEKË**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKB nr. 81, datë 18.12.2023 “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe buxhetin për vitin 2024”, Ekipi i programit të menaxhimit për të vazhduar me procedurat e mëtëjshme të zbatimit,

KËRKON:

1. Miratimin e blerjes së rërës bituminoze për shtrimin e rrugës nga “Qendra e Siqecës deri në qendrën e Drenies” me vlerë 3,003,588 (tre milion e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.
2. Fondi për blerjen e rërës bituminoze do të mbulohet brenda programit shërbimeve urbane duke përdorur një pjesë të fondit parashikuar për blerje asfaltobeton.

**EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT**

Ermenita MICI

Afërdita MUÇO

Gazmira PLESATI

Eduard REFITAJ

Nurkë HAZIZAJ

Silvana MICI

Ardit NGJELIU

Marsilda LIZAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS

Nr. 1538 / Prot.

Patos më, 12/06 /2024

### RELACION PËR PROJEKT-VENDIM

#### **BLERJE RËRË BITUMINOZE PËR SHTRIMIN E RRUGËS “NGA QENDRA E SIQECËS DERI NË QENDRËN E DRENIES” ME VLERË 3,003,588 LEKË**

Bashkia Patos ka zhvilluar disa dëgjesa publike për evidentimin e kërkesave prioritare dhe problematikave në Njësinë Administrative Ruzhdie. Gjithashtu ndaj bashkisë Patos janë adresuar disa herë kërkesa nga kryetari i njësisë dhe banorët e zonës, të cilët po përballen me vështirësi nga më të ndryshme për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore.

Segmenti më problematik rezulton të jetë segmenti që lidh dy qendrat Siquece dhe Ruzhdie, me një gjatësi prej 5 km, gjendja e së cilit është mjaft e rënduar. Mungesa e investimeve prej vitesh në këtë njësi ka sjellë vështirësi për qarkullimin e banorëve dhe kufizimin e aktiviteteve të tyre të përditshme si bujqësore dhe blegtorale.

Si rrjedhojë e mungesës së ndërhyrjes përgjatë viteve në këtë zonë, koston së lartë që ka realizimi i rrugëve nëpërmjet një projekti të mirëfilltë infrastrukturor, është përzgjedhur që shtrimi i rrugëve në bashkëpunim me Agjencinë e Shërbimeve Publike të realizohet me rërë bituminoze, duke pasur parasysh që janë rrugë me një fluks qarkullimi të ulët deri në normal.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit ka hartuar preventivin për realizimin e shtrimit të rrugës me rërë bituminoze, me gjerësi që varion rreth 3 m përgjatë gjithë gjatësisë. Vlera e ndërhyrjes është 3,003,588 (tre milion e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë, vlerë e cila do të mbulohet brenda programit shërbimeve urbane duke përdorur një pjesë të fondit parashikuar për blerje asfaltobeton.

Punimet për shtrimin e rrugës do të kryhen nga Agjencia e Shërbimeve Publike, Patos.

Efektet e pritshme nga zbatimi i projektit është krijimi i një infrastrukturë të qëndrueshme rurale për banorët e zonës.


#### **Nisur nga sa më sipër, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë:**

1. Miratimin e blerjes së rërës bituminoze për shtrimin e rrugës nga “Qendra e Siquecës deri në qendrën e Drenies” me vlerë 3,003,588 (tre milion e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

2. Fondi për blerjen e rërës bituminoze do të mbulohet brenda programit shërbimeve urbane duke përdorur një pjesë të fondit parashikuar për blerje asfaltobeton.

**EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT**

Ermenita **MICI**



Afërdita **MUÇO**



Gazmira **PLESATI**



Eduard **REFITAJ**



Silvana **MICI**



Ardit **NGJELIU**



Marsilda **LIZAJ**



**KRYETARI**

Fation Duro





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TERRITORIT**



**MIRATOHET**  
**KRYETARI**  
Faton Duro

**BAZE MATERIALE**

**Objekti : Blerje rere bituminoze per shtrimin e rruges**

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Rere Bituminoze	ton	1370	1827	2,502,990
	<b>SHUMA</b>				<b>2,502,990</b>
	<b>TVSH 20%</b>				<b>500,598</b>
	<b>SHUME ME TVSH</b>				<b>3,003,588</b>

Hartoi: Ing. Ermenita Mici



<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna  
gjëhapësimore të ofruara nga autoritetet publike  
përgjegjëse.  
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e  
autoritetit publik që i ka krijuar ato.